



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1- /113  
Br.

Data 23.08.2023  
Datum

OBILIQ-OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtezakonshme e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.04.08.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK),

**Të pranishmit tjerë:** Drejtorët komunal, përf.e KFOR-it, përf.e OSBE-së dhe qytetarët

**Munguan:** Shaip Paloja, Linda Sadiku Krasniqi, Samire Berisha, Ratomir Ristic, Biljana Spasic  
Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cilapasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

**1.Shqyrtimi i kërkesës lidhur me shpronësimin e pronave të pronarëve fizik (banorëve nga fshati Siboc konkretisht lagjet Megjuani dhe Kongjeli nga KEK-u, dhe Qeveria**

**Kryesuesja** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal konstatoj se kourum ka nga 21 anëtarë të kuvendit 15 janë të pranishëm, materialin e keni pranuar, kërkesën së bashku me listën e nënshkrimeve. Të nderuar antarë të kuvendit komunal fjalën ja kalojë inicuesve të mbledhjes.

**Xhelal Krasniqi** – I nderuar Kryetar i komunës, të nderuar delegatë, të nderuar të pranishëm, të nderuar qytetarë të fshatit Sibovc. Duke marrë parasysh shqetësimet e fshatit Sibovc gjegjësisht lagjet Kongjeli dhe Mexhuani në lidhje me shpronësimet e zhvlerësuar të pronave të tyre nga organi shqyrtues, Ministria e mjedisit planifikimit hapsinor dhe infrastrukturës gjegjësisht zyra e vlersimit të pronës e cila funksionon në kuadër të departamentit të tatimit në pronë pranë kësaj Ministrie. Konform nenit 44 të ligjit 03/L040 për vetëqeverisje lokale ne si grup i falenderojmë në emër të AAK asambleistët nga IQO, LDK, PDK, LB me këtë pikë të rendit të ditës shpronësimi i pronave të personave fizik për banorët e fshatit Sibovc nga ministria e mjedisit dhe planifikimit hapsinor dhe infrastrukturës për nevojat e korporates energjetike të KEK-ut. Gjatë javës së kaluar kemi pas shqetësime nga banorët e fshatit Sibovc, gjegjësisht lagjia mexhuani dhe kongjeli për

zhvlerësimin e tejskajshëm të pronave të tyre nga ana e organeve kompetente sipas dokumenteve që posedojnë banorët kemi ardh në përfundim se ata janë mashtruar nga autoritete shpronësuese në ofertën e viti 2020 të nënshkruar me përfaqësues me inicialet I.G kanë qenë tjera oferta. Ndërsa, gjatë vitit 2023 këta qytetarë janë të njoftuar se tashmë pronat e tyre janë bartur si prona të KEK-ut dhe se vlera monetare e pronave të tyre gati se është përgjysmuar, në vlerësimin e vitit 2020 metri katror është paguar me 350 euro kurse me ofertën e vitit 2023 metri katror është paguar nga 150 deri në 175 euro. Ne si qytetarë e dijmë se pas inflacionit dhe rritjes së tatimit në pronë në tërë territorin e Kosovës ka ndodhë edhe rritja e vlerës së pronës, por fatke është për këta banorë ka ndodhë zhvlerësimi i pronës së tyre. Ne i kemi marrë disa shembuj, qytetarët me inicialet L.K për shtëpi banimi në 2020 është vlerësuar me 43.000 euro dhe për këtë ka dhënë nënshkrimin kurse në vitin 2023 po ky qytetar është njoftuar se prona e njejtë është bartur te Keku në vlerën prej 17.270 euro. Qytetari tjetër, me inicialet I.K me ofertën e vitit 2020 është pajtuar për ofertën 49.758 euro kurse në vlerësimin që është bërë në vitin 2023 i është prezentuar se kompenzimi do të ndodhë prej 25.746 euro. Qytetari tjetër me inicialet F.K ka nënshkruar për të bërë zhvlerësimin në vlerën prej 71.151 euro ndërsa në vitin 2023 po i njejtë është njoftuar se do të kompenzohet në vlerën prej 25.746 euro. Në këto dy lokalitete si shqetësim tjetër i qytetarëve është se në dy lokalitete veprojnë 4 biznese ku këto biznese janë vlerësuar si shtëpi, pronë dhe me disloktimin e këtyre bizneseve do të vjen deri te mbyllja e tyre për shkak të mos trajtimit me ndjeshmëri si biznes, por si pronë private. Atëherë konsiderojë se ne si Kuvend komunal që kemi marrë mandatin drejtëpërdrejtë nga qytetarët tonë e kemi për obligim ligjor dhe moral që ta ngritim zërin kundër kësaj loje të paprecedentë nga ana e Ministrisë së mjedisit, planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës dhe të kërkojmë nga kjo e fundit që të ndalë ofertën që e ka bërë dhe të bëjë rivlerësimin urgjentë të pronave të paluajtshme duke marrë për bazë vlerën reale të tyre, siç e përcakton neni 22 i Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, vlerë kjo e cila në asnjë variantë nuk bënë të jetë nën ofertën e vitit 2020. Edhe njëherë çka ka kërkuam nga ju kryesuese dhe të pranishmit është që ta trajtojmë këtë rast sepse qytetarët e keni parë edhe në media se si kanë reflektu. Ne e kemi marrë materialin të gjithë për këta qytetarë dhe kërkesa e tyre është që ne si Kuvend të kemi një rekomandim për Ministrinë dhe KEK-un që të bëjë o rivlerësimin e pronave duke respektuar ofertën e vitit 2020, o të delë me një rivlerësim tjetër që kompenzimi të jetë ekuivalent dhe i mundshëm për këta qytetarë sepse ne e pamë që 150 euro është pagu metri katrorë kurse oferta në Obiliq për shtëpi ose për banim është rreth 650 euro.

**Enver Gashi** – Mendoj se është mjerim me vlerësimet që i ka bërë Ministria dhe KEK-u, në këtë rast të pronave të qytetarëve të fshatit Sibovc dhe e njejtë Qeveri nuk i ka 1 vit të plotë e delë edhe e rritë vlerën e tatimit. Tatimi rritet kur është vlera e pronës dhe nuk ka nevojë kjo Qeveri me zbulue sot ujin e nxehtë se moti është zbulu. Janë bërë dy vlerësime, edhe në ato vlerësime që dallojnë shumë me këto të tanishmet ka pas vërejtje, se nuk është lehtë me e lëshu pronën, me e lëshu shtëpinë vetëm ai që e ka lëshu ai e din edhe të nënvlerësohen këta qytetarë, sot ne si Kuvend e kemi obligim që së paku të ia dërgojmë një shkresë Ministrisë edhe KEK-ut, që të bëhet një vlerësim i dinjitetshëm, jo siç e tha parafolësi im nga 600 në 150 e 170 e ku me ditë çka bohet. Mirëpo, si total po delë mbi 50 % ku e dijmë na që për këto vite 2020 edhe 2023 kemi pas ë edhe inflacion në vend që të rritet ma shumë këta kanë shku shumë ma poshtë shumë ma shumë se 50 %, e dikund afer 70 %/ Andaj, iu kisha lutë të gjithë anëtarëve të Kuvendit, sot të ia bëjmë një apel Qeverisë edhe KEK-ut, që ta rivlerësojnë jo në atë z.Xhelal qysh the qysh ka qenë më herët, por të merren për bazë edhe sa janë inflacionet e 3 viteve të fundit edhe të vazhdohet me atë koficientë të vlerësohen edhe këta qytetarë.

**Sami Ahmeti** - Unë po flas posaçërisht për banorët e fshatit Sibovc edhe para inicimit të kësaj seance, posa qytetarët kanë marrë vendimet e para unë së bashku me deputetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kemi takuar ministrat e linjave sepse nuk është vetëm ministri i ambientit, ai i cili ndërlidhet me këtë proces dhe kemi biseduar për komplet rrjedhën e këtij procesi qysh ka shku. Ministrat në këtë rast na kanë njoftu se si ka shku gjendja, ky proces nuk është zhvillu prej procesit politikë dhe nuk ka fillu prej ministrave, apo ndonjë funksionari të lartë politik. Ky proces është zhvillu prej Komisioneve profesionale të cilat janë në Ministrinë për një kohë të gjatë që prej pasluftës, edhe ne kemi vërejtjet tona për këtë proces. Mirëpo, duke qenë edhe vetë staf politik, ne e kemi parim që nuk përzihemi në punët e institucioneve ose Komisioneve profesionale, por kjo nuk do të thotë që ky Komision ka bërë punën siç duhet derisa nuk ka pasur asnjë ankesë në Ministrinë gjegjëse, ministrat ose stafi politik nuk ka mundësi me u marrë me atë çështje sepse nuk ka pasë ankesa as prej institucionit, as prej kësaj Komune, që do të duhej të kishte një zot shtëpie. Pra, deri në këtë moment nuk ka shkue asnjë ankesë në Ministri, të paktën prej informatave sa unë i kam. Ne kemi zotim nga ministrat e linjave që posa të vjen një kërkesë ose ankesë prej qytetarëve, ne do të merremi me seriozitetin më të lartë në lidhje me këtë çështje edhe me vlerësimet ne e kemi parasysh që Komisionet kanë bërë vlerësime për çka edhe ne pajtohemi që diçka nuk është duke shkuar mirë. Po ashtu, kemi zotimin e ministrave që posa të vijë një kërkesë nga qytetarët, do të trajtohen dhe në mundësinë e parë ky proces do të shkojë në rivlerësim si LVV, si këshilltarë ne jemi të gatshëm që qytetarëve të iu ofrojmë mundësinë edhe eksperiencën tonë qoftë në ndihmën në lidhje me ankesat, qoftë edhe në takime ndërministrrore që këtë proces me e kthy edhe njëherë në 0. Deri në ora 16:00 në mbrëmje sipas informatave që i kam nuk ka pas asnjë ankesë në Ministrinë gjegjëse, prapë po them kjo nuk do të thotë që ne pajtohemi me këtë vlerësim, bashkëndejmë dhe shpresojmë që qytetarët derisa pronat janë në interes të shtetit dhe janë të nevojshme për shtetin shpresojmë që kurdo që dalin nga aty, të dalin dhe të kenë mundësinë të kenë një jetë të re pa probleme në një lokalitet të ri. Ne nga momenti i përfundimit të kësaj seance, qysh edhe i kemi kontakti qytetarët më herët jemi të gatshëm me ju dalë krahë edhe me shty këtë proces në rivlerësim. Sa i përket tatimeve në pronën e vlerës së tatimit, nuk është mirë me i përzie gjërat sepse vlerën e tatimit në pronë nuk e rritë Ministria, por e rritë vetë vlera e saktë qysh do të duhej të ishte dhe këto janë tema të tjera për të cilat ne kemi marrë vendim për njëherë prej tyre në njëerën prej seancave tona të jashtëzakonshme me inicimin tonë e që deri në këtë moment nuk është duke u bërë asgjë në atë drejtim. Na jemi për bashkëpunim me qytetarët ti mbështesim në çdo aspekt, por nuk jemi profesionistë të vlerësimit. Ne e dijmë që shuma sipas informatave që i kam nuk i plotëson kushtet për fillimin e një jete të re megjithatë, ne kemi krejtë vullnetin edhe e kemi porosinë që ky proces të zhvillohet siç duhet sepse pa ankesa nuk mundet me u zhvlerësuen një vendim i një Komisioni i cili është profesional dhe shumë prej juve keni mund me i pasë kolegë edhe më herët.

**Ajet Berisha** - Unë e përshëndes iniciuesin edhe pse ju kam bashkangjitë kërkesës së tij, fillimisht është aspekt krejt ligjor mbrojtja e interesit të qytetarëve tonë, e kemi detyrë si të zgjedhur politik dmth në asnjë formë pavarësisht vlerësimeve asnjëherë nuk mund të largohet nga përgjegjësia, por politika i cakton edhe kriteret për një mall. Kjo ishte veç një përgjegje që dmth që nuk mundet me i ikë përgjegjësive udhëheqja e Komunës pavarësisht që nuk është e thirrur në këtë rast as për vlerësim, por është e thirrur për me mbrojtë interesin e qytetarëve, kufijtë e Komunës së vet. Mendoj që është e drejtë që është thirrë edhe është shumë me interes me i pa hapësirat ligjore qysh munden me vepru edhe me stopu këtë krahurë që ka ndodhë me pësimin e dytë, është fillimisht problem ligjor në rast se qytetarët tonë kanë pranë një vlerë të caktuar të vlerësimit dhe e kanë nënshkru. Mirëpo, çka ka ndodh vlerësimi i dytë pse këtyre ju ka ardhë një dokument jashtë asaj

çka kanë nënshkru këta, dmth fillimisht është gjygjësore dhe këta duhet me e dergu këtë lëndë në Gjykatë, se këta kanë nënshkru diçka tjetër e ju ka ardhë për pagesë diçka tjetër. E dyta, për me thjeshtësu këtë punë po e marrë një shembull që po e abstrahoj nuk e di a ekziston abstrahimi shembull por një familje 4 antarëshe në lagjen Mexhuani mundet me pasë një shtëpi të vjetër 70 metra katrorë, në të cilën ai jeton aty dhe s'ka tjetër mundësi aty, ja ka lënë baba një shtëpi ndoshta krejtë e amortizuar, por ai aty jeton. Tani, shkon Komisioni profesional nga Ministria e financave, edhe ata për shkak të metrit katror pak që ka, për shkak të amortizimit që ajo është ndoshta llogarit shtëpia, por ai s'ka pasë edhe e vlerëson 10.000 euro. Ne a duhet me i thënë mirë ia ka bo, jo jo ai erifi është në pronë të vetë, ai e ka qata qaty ka jetu qe sa vite dhe ti nuk munesh me marrë atë me hudhë në rrugë e me i thënë ti bo çka dush tash me 10.000 euro. Mendoj se është përgjegjësi e jona, se ne këta njerëz po i marrim po i qesim në rrugë, edhe po i thojmë është vlerësim profesional. Ai po dashti me dalë prej atyhit le të bën çka don, por sot prona e tij po ie vyn dikujt dhe në rast se prona e tij ka me i vye dikujt atëherë çka duhet me bë ai, duhet me ia sigurue kulmin mbi kokë, minimalisht me ia siguru plus tjerat. Po e marrë një shembull në trajnimet e mëhershme OSBE-, na e ka tregu një rast të shpronësimit në shtetet evropiane, në një lagje në një shtet evropian duhet me i shpronësu se po bëhet liqeni dhe në atë pjesë edhe shkojnë i lusin me shumë pare secilën familje, dojnë me bo kontrata, jo jo në fund thojnë është një zgjidhje, cila është ajo thotë merrne skemën e fshatit dojmë krejtë kështu qysh është fshati me na e bo në një vend tjetër, që këta me e perjetu më lehtë, du me pas kojshin, du me pasë formën e shtëpisë, du me pasë rrugën, du me pasë një liqen të vogël që kjo trauma e migrimit me ndiku sa ma pak në jetën time. Edhe pajtohen e bajnë në fund në një lis, paska qenë një fole e lejlekut edhe nuk pranojnë pa u bë edhe ajo fole e lejlekut. Këtë, po du me e tregue, ndjeshmëria kur ti e detyron dikon me u largu nga shtëpia e vetë nuk shkon përmes vlerësimeve profesionale, se këtu metri katrorë po u shitka 50 euro, fatkeqësisht këta edhe e kanë ulë ty po vyen prona, ty po vyen toka, ti mua ke me ma bërë ashtu qysh unë pranoj, pa nënshkrimin tiam ti mu s'mundesh me më largue atje. Obligimi jonë është me i ndjekë të gjitha rrugët me iu dalë në mbështetje qytetarëve tonë, që mos me na u shëndrru në problem tonë se këta nesër nëse, shkon në këtë formë këta kanë me u shëndrru në problem buxhetor të Komunës, kemi me u detyrue me ju bë banesa, kemi me u detyrue me iu bë shtëpi, pse me e marrë barrën Komuna më e vogël, 1 %, që e përfaqëson Kosovën me e marrë barrën e interesit të 99%, në këtë drejtim. Nuk po themi me bë mrekulli, ne po themi që këta me u zhvendosë në mënyrë të dinjitetshme, kemi shembuj edhe herën e kaluar Ramushi kur i pati zhvendosë jo kanë vjedhë, jo jo s'kanë vjedhë nuk është lehtë ti kapi gjërat qu dilë prej këtu se po më duhet mua, ti ke me pagu këtë punë, kjo duhet me të kushtu, i kushton shtetit, i kushton KEK-ut sepse këta s'po dalin me vullnetin e tyre. Neve po na përsëriten këto raste, nuk po më intereson kush është Qeveria, nuk po më intereson ndoshta dikush me përfitu në emër të kësaj nuk është qëllimi aty, qëllimi është na Komuna jonë, udhëheqja e Komunës, Aambleja komunale, bashkë me qytetarët tonë në këtë drejtim duhet me qenë një gojë që qytetarët tonë kur të zhvendosen me dalë në mënyrë të dinjitetshme të kënaqur. Këta, asnjëherë sado me ju dhënë nuk dalin prej atyhit sepse aty kanë histori, kanë përjetime, vështirësi kanë kujtime është gjithë që edhe me dëshirë kur dalin njeri nuk vjen në vete me vite të tëra kur largohet nga shtëpia që ka lind dhe u rritë, e jo ti dhunshëm qu dilë se po më vyen, unë ta paguj sa të dua 20.000 euro, ku mundet me ble sot as garsonjerë me 17.000 euro në Obiliq nuk mundesh me ble, ku ka me jetu ai. Këtij, duhet me ia bë sikur me jetue në Pejton, doren në zemër nuk shkon ky vlerësim profesional, por për këtë punë këta duhet me marrë përfaqësues ligjor për dolloverin që ua ka bërë zhvlerësimin që është dashtë me u pague kjo, pse unë me humbë kohën time pse ai po don me bë dollover e me shitë mend, pse për çdo vjet na me bë kritere të reja janë bë disa kritere janë disa shembuj qysh është zhvendosë Shipitulla, pse nuk

është marrë ai kriter, jo po na kushton. jo s'po na kushton hajgare është kjo. Une po foli që u mundova me u sjellë sikur në Oda që me mund me u kuptue më thjeshtë se nuk është kaq e lehtë kjo qu dil, unë po ti dha paret dhe bo çka dush, hiç s'mundesh me më larguet prej shtëpisë edhe pikë.

**Xhelal Krasniqi** - Po më duhet me e ruajtë edhe debatin, nuk është në interes të partive politike por në interes të qytetarëve pajtohem plotësisht me të vetëm në një vend nuk pajtohem kur z.Sami tha që Ministria e ambientit nuk është kompetente për të bërë vlerësimin. Ne e dijmë që stafi politik nuk merren me këtë punë, por sektori i caktuar dhe zyra e vlerësimit të pronës funksionon në kuadër të kësaj Ministrie, e këta ministra pasi e kanë pa prononcimin në media është dashtë me reflektu kundër tyre. Sa i përket anës ligjore, ne e kemi inkuraju prej fillimit në bashkëbisedim me disa zyrtarë ligjor që e drejta e tyre është që të bëjnë padi karshi të drejtës së tyre elementare.

**Enver Gashi**- Të nderuar të pranishëm, po flas nga përvoja e vlerësimit të fundit para këtij, atëherë atë e ka vlerësu një Komision i pavarur një kompani që është e licencuar dhe ka renome evropiane. Tash delë një Komision i ashtuquajtur profesional nga Ministrinë, a me qëllim a pa dije mirëpo unë mendoj edhe është e arsyeshme që nuk bën unë me vlerësu edhe unë me pagu është një konflikt interesi këtu është thjesht konflikt interesi, Komuna me vlerësu edhe Komuna me pagu nuk bënë. Ministria ose KEK-u, e vlerësojnë edhe e paguajnë, për atë unë ju kisha lutë qytetarëve që menjëherë me bë ankesë, por ankesa kryesore me qenë edhe te vlerësimi i Komisionit. Komisioni duhet me qenë i pavarur, ka kompani ndoshta në Kosovë nuk ka, por ka në regjion të cilat e bëjnë vlerësimin taman qysh e tha z.Ajet, edhe për lejlek duhet me bë edhe për ëndërr që e ka pa aty, edhe për fëmijët që kanë luajtur nëpër atë oborrin aty, e jo qe 17.000 euro, bo çka dush ose z.Samiu thotë s'ka ankesa dhe ankesat janë prej këtij Kuvendi. Unë ju kisha lutë asnjë qytetarë hiç mos te nënshkruan sepse e din sa ka marrë në megj bash në megj Shipitulla është Kongjel e Mexhuan tjetër vlerësim, tash edhe kur tha mos e përziej tatimin jo tatimi rritet kur rritet vlera e pronës. Këtu, ka ndodhë e kundërta, ta ka vlerësu ulët a tatimin e ka rritë sepse ka thënë prona vlenë më shumë.

**Sami Ahmeti** - Qytetarët neve na njohin të gjithëve, edhe s'kemi nevojë me bë skena se secili e kemi nga një histori, e kemi pasë mundësi me tregu se sa të ndjeshëm jemi në raport me qytetarët. Unë e thashë qysh në fillim që edhe për mendimin tonë diçka nuk është duke shkue me këtë vlerësim, nuk e thashë që Komisioni profesional i Ministrisë, Komisioni profesional është i kompanisë se e din secili zyrtarë që i ka lexu dy rreshta tekst, instutacioni i cili e bënë pagesën nuk e bënë vlerësimin. Në ndërkohë që para inicuesit unë nuk thashë që nuk është Ministria e ambientit, por thashë që nuk është e vetmja, është e fundit Ministria e financave ajo e cila e bënë transferin e mjeteve. Pajtohem dhe jemi për që ky vlerësim të bëhet rivlerësim, është kompani e personave personal sepse personat politik pajtohem që bëjnë disa kriterë megjithatë, nuk merren me vlerësimin sepse nuk shkon në domenin e tyre, kështu që me rëndësi si do që të vijë fundi ne jemi që të bëhet vlerësimi i fundit edhe që këta qytetarë kurrë nuk mundën me dalë mjaftueshëm të kënaqur prej atyre përjetimeve që i kanë bë. Pajtohem plotësisht që është interesi i shtetit, edhe shteti duhet me i pague ashtu siç duhej të ishte qysh e thashë edhe më herët që ata qytetarë ta kenë mundësinë që ata të fillojnë një jetë të re ndoshta, jo krejtë me ata lisat me ato folet e lejlekëve, por bile me fillu një jetë taman qysh i takon një qytetari. Unë po e ripërserisë, ne e kemi vullnetin e plotë që me shfrytëzu secilën vië instutucionale sepse një ministër ose një qeveri nuk mundet me e rrëzu një vendim të një kompanie, e cila është e licencuar për atë çështje përderisa nuk ka ankesa ose është vetëm një ankesë në një televizion ne e dimë sepse krejtë punojmë në instutucione se ankesa nuk bëhet vetëm në televizion, ajo bëhet në organet gjegjëse. Gjithsesi, që jemi për me bë ankesë në Gjykatë, ne shpesh e dimë që ka vendime kondratiktore, nuk po dua këtu me shitë moral,

por problemi është që të bëhet në vendin e duhur. Institucioni i cili e ka marrë vendimin duhet ta marrë ankesën në mënyrë që ta kthejë ankesën në rivlerësim, kjo është dhe nuk kam asgjë kundër vlerësimeve. Ky e ka një fill dikund, këto vlerësime, vlerësimet dhe çështja e tyre keqperdorimet e kanë edhe në Hade që sot ende qytetarët meritojnë që meritojnë me dalë vuajnë për shkak të keqperdorimeve që kryesisht edhe vetëqeverisja lokale i ka lejuar me u bë nga 7 milion sa ka qenë e paraparë me u bë zhvlerësimi i pronave në Hade, ka kaluar në 28 milion. Kjo qeverisje lokale lejon edhe ka leju bile bashkëpunorët me mbjellë pemë vetëm për me zhatë buxhetin e shtetit edhe tani ua rrezikon edhe i vë në lajthitje institucionet, që në të vërtetë për ata që kanë nevojë mos me marrë ata t ë duhurën jemi që qytetarët të marrin vlerësimin ashtu siç ju takon. Mirëpo, nuk jemi ata që mundemi me vendosë për diçka të tillë, ne jemi për me iu kërkim institucioneve, që ato ta vlerësojnë qytetarin ashtu siç e meiton.

**Jeton Mjekiqi** - Po më doket më shumë z.Sami po e mbronë qeverinë se qytetarin e Komunës së Obiliqit, Ne nuk kemi ardhë me mbrojtë Qeverinë na kemi ardhë me mbrojtë qytetarin tonë dhe me këtë vlerësim që e kanë bë ne e dimë se nuk mundem me ia dalë. Ne nuk kemi ardhë me bë politikë cilën parti po e mbrojmë, bile të paktën sot nuk duhet. Sa i përket zotit të shtëpisë, ne e dim që ka kjo shtëpi një zot shtëpie, e dimë se e ka tregu veten edhe kur është shpërngulë Shipitulla, edhe kur është shpërngul Hadja, edhe kur u bë a kanë mbjellë ara, që ka edhe prej Kongjelve që kanë mbjellë ara, por nuk kemi ardhë me folë për ara sepse jemi mbledhë me folë për vlerësim të shtëpisë. Ne shumica e dimë qe te Kongjelët dhe te Krasniq t nuk kanë mund me ndërtue shtëpi, kështu që të paktën inicimin me ua dhënë hapur për shtëpia. Ne nuk kemi ardhë me ju thënë me ua pagu arat, por me ua pague trollin, me ua pague shtëpinë, aty ku jeton të paktën sot. Ne si asambleistë duhet me i dalë zot atij qytetari që ka nevojë për neve, ndërsa për Qeverinë a ka vërejtje mendoj se ka vërejtje shumë sepse secila që ishte e ka nga një vërejtje, por na duhet me bë përpjekje që qytetarin tonë mos me e dëmtue.

**Ajet Berisha** - Në përgjithësi, e pashë që Kuvendi është i pajtimit që ky vlerësim nuk është në rregull për qytetarin tonë dhe po mendoj më shumë se nuk është nevoja për me gju me gurë njëri tjetrin, por është për me bashkëpunu në këtë drejtim secili rrugës së vetë që me u gjetë zgjidhja. E para, unë po propozoj diçka z.Samiu me qytetarët me u ulë edhe me i bë ankesat në bazë të shkrimeve me i bë ankesat edhe në Ministri këto ankesa me u bë edhe juridikisht me rregullë që kjo qeverisje lokale, apo Komuna me e pagu dikend një zyrtarë ligjor ose me e dërgu këta, që në mënyrë juridike me u bë ankesat. Po ashtu, me e përgatitë një dokument nga Komuna me vendim e pëlqim të Kuvendit, që me dalë në mbrojtje juridike e kjo mbrojtje juridike me u pague prej Komunës, për këta qytetarë që këta me mund me nxjerr interesin e vetë normal me standarde ku po synojmë me shkue, me standarte evropiane, që këta kur të shpërngulen prej atyhit me mund me jetu dinjitetshëm. Në këtë po më duket se jemi të gjithë të pajtimit dhe ka pasë gabime edhe lokale edhe qëndrore, ka pasë edhe shpronësime kur qytetarët janë nda të kënaqur. por me keqperdorime gjithmonë duhet me u marrë ai që është përgjegjës.

**Afrim Mexhuani (qytetar)** - Ne kemi tentu me bë ankesë në Ministri, por Ministria na ka thënë që nuk kemi të drejtë me bë ankesë. Edhe e dyta pse me bë ankesë ne për tokat tona, pse me shkue në gjyq, pse me pagu ne pare për vendin tonë. Z.Sami, i kisha thonë që ata ndoshta janë ekspertë që na e kanë bë vlerësimin, por edhe ne jemi më ekspertë për tokën tonë dhe nuk e kanë bë katastrofë apo na e kanë bë nuk e di a janë ekspertë a nuk janë. Nuk mundesh me thënë që ata e kanë vlerësu mirë sepse nuk është mirë. Unë e kam biznesin atje dhe mua prona më ka dalë në emër të KEK-ut, që nuk e di se qysh më ka dalë sepse askund nuk kam nënshkrue. Une kam vend edhe te shkolla ku mundem me zhvillue biznesin, por dua me i tregu Kryetarit që atë ditë që vijnë

më largue atje, unë kam me marrë shtallën atje, s'kam dëshirë asnjë inspektor me ardhë me ma prish shtallën ose le të ma bëjnë një zgjidhje.

**Labinot Mirena** - Unë vijë prej fshatit Hade, dhe më së shumti ua dimë dhembjen. Na me qenë në pozitë të z.Sami edhe në Vetëvendosje, unë nuk kisha fol fare, bile mua më kish ardhë turp nëse, kish folë dikush e unë isha kundërpërgjigje, por këta qysh janë mashtrues vazhdojnë me mashtru edhe në Asamble. Mirëpo, kryemashtruesin e keni të Sibovcit, ai që ju ka mashtru për shpronësim, për punësim e krejtë na jemi me juve edhe pajtohem me Afrimin plotësisht që tha shpronësimi u bë i tmerrshëm edhe mos pritni prej kësaj Qeverie kurgjë, unë jam me Sibovcin.

**Valon Svirca** – Z.Sami, as nuk e mbrojti Qeverinë as kurgjë, por tha që nuk është në rregullë te vlerësimi. E dyta, tha duhet me bë një ankesë, ekspertët profesional, normal ashtu edhe quhen, por a janë profesional apo jo ata munden me marrë si vendim tjetër kush. Ne nuk mundemi me vlerësu, sigurisht u pajtu që nuk u bë vlerësimi mirë dhe për që është mashtrues është mirë z.Labinot, me tregu diçka që është mashtrues, çka ka premtu që se ka bë, nuk ka as kompetenca as nuk i shpronëson. Nëse jeni mësuar ju me ministrat e juve, drejtorat e juve, jeni mësuar me i përzie pazaret e tash në këtë Qeveri nuk ka. Do të thotë deputeti është deputet as nuk merret me vlerësim, as nuk ka kompetenca, ai e ka mundësinë për me hap deren për ndonjë hall të qytetarëve, por nëse jeni mësuar kur janë bë shpronësimet në Shipitullë, e në Hade me shku Kryeministrat e ministrat me bo shpronësimet qysh ju konvenon me këtë qeveri nuk ka.

**Labinot Mirena** - Deputeti i ka dyert çelë në nivel qendror qe 4 ditë ka ankesa dhe nuk ka mundur deputeti si shok i Afrimit, që është me marr =ë Afrimin e me shku me bë ankesë direkt në Qeveri. Ne jem për kërkesat e qytetarëve, unë në Hade, Valon hala mue nuk më ka shpronësuar asnjë Qeveri.

**Kryetari** - Singerisht unë jam i shqetësuar me këtë që është duke ndodhë edhe janë të shqetësuar gjithë qytetarët e Obiliqit. Nga parafolësit dikush e tha që është mirë me pasë unitet edhe unë mendoj që në këto situata duhet të ketë unitet të përbashkët sepse interes në këtë rast është qytetari i Komunës tonë. Unë sa kam mund me kuptue këtu, janë dy vlerësime, nga kompania profesionale është vlerësimi i parë dhe vlerësimi i dytë është nga Ministria e Financave. Ministria e financave, e ka bë vlerësimin me Ligjin e shpronësimit edhe pikërisht barra bie mbi Ministrinë e Financave pa dashtë me ataku kërkon në aspektin politik, duke e ditë që ne kemi pasë shpronësimet të shumta në Komunën tonë, jo vetëm në zonën e interesit por edhe në zonat tjera nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, apo nga operatori i KEK-ut që pronar është Qeveria. Pra, kërkohet që të bëhet vlerësimi përmes Ministrisë së Financave, e cila e ka një Departament i cili merret me vlerësim. Mendoj që vlerësimi është jashtëzakonisht i ulët dhe duhet me ngritë këtë interes të bashkuar pa dashtë me nënçmu në aspekte politike, qytetarët kanë nevojë më shumë se kurrë që ne të jemi të bashkuar. Ju lus të gjithë anëtarët e Kuvendit, ti lënë aspektet politike edhe ankesat e z.Sami, që po thotë për Komunën nuk ka bërë asgjë, mbi të gjitha unë mendoj që edhe deputeti edhe këshilltari i ministrit edhe na si institucion komunal, edhe delegatët edhe qytetarët edhe zyra ligjore, ekspertat e krejt çka kemi duhet me u angazhu në këtë drejtim që të jetë sa më në nivel. E vërtetë është se shqetësimin e kanë paraqitë qytetarët, kanë pas takim edhe me KEK-un. në disa raste ka marrë pjesë edhe Komuna dhe na duhet me u mundue bashkarisht me u kordinu me Ministrinë me i shprehë shqetësimet sepse singerisht është e pa pranueshme, me 17.000 euro, nuk mundesh me bë ndonjë zgjedhje. Zhvendosjet e detyrume në njëfarë forme janë të dhunshme, gjithçka duhet me u mundu me kompenzu edhe me qenë në kordinim me vetë qytetarët

**Kryesuesja** - Të nderuar anëtarë të kuvendit atëherë shkojmë me rekomandime për Ministrinë e linjave dhe KEK-un.

**Ajet Berisha** – Mendoj se është dashtë me ulë sot z.Sami, edhe detalisht me pa fuqinë e tyre ligjore, edhe humane njerëzore qysh munden me ndihmu për shkak se ka lidhje për mundësi edhe

me Halilin atje, me ndërpre këtë veprim, ligjërisht qysh mundet me u ndalë ky veprim që është bërë. E dyta çka mundet me ndihmu Kryetari dmth këto konkluzione në aspektin juridik me u nxjerrë që na ndihmojmë e merrë përsipër Komuna o si pagesë, o si ekspertë që i ka brenda Komuna edhe bashkë edhe nalt edhe posht çka munden me bë që këta, me nxjerrë maksimumin. Mendojë se rekomandimi nuk ka me na ndihmu edhe pse pajtohem se na më shumë nuk mundemi me bë, por me nxjerrë diçka bazike çka mundemi me bë na, çka mundet me bë Kryetari, çka mundet me bë z.Samiu.

**Kryetari** – Nëse, mundem edhe njëherë, është mirë paraprakisht me e caktu një Komision prej Kuvendit, Ekzekutivit gjithashtu me qenë përfaqësues edhe Kryetari i fshatit me u ulë me i nxjerrë konkluzionet në bashkëpunim me zyren ligjore dhe bashkarisht ta trajtojmë dhe ti adresojmë nëpër vendet e duhura, te ministri i ambientit, te ministri i financave te KEK-u edhe shpresojë që ata e trajtojnë.

**Sami Ahmeti** - Afër 5 herë mu përmendë emri dhe deshta me marrë fjalën, krejtë me i ndihmu këtij debati, e absolutisht as në fjalimin tim të parë, por është pak problem që ndoshta ka edhe persona që si kuptojnë duke mos i përfshi banorët e thashë qysh në fillim e kemi krejt vullnetin me ndihmue. Unë nuk e përmenda në aspektin qeveritarë po e mbështeti ose nuk po e mbështeti sepse në fund këtu, e kemi jetesën edhe këtu bashkëpunojmë. Edhe krejt me jetue me këta qytetarë me rëndësi është që këta qytetarë me u merrë sepse nuk janë vetëm këta qytetarë edhe prapë pas këtyre shpronësime kanë me u bë edhe në lagjet tjera, me u kriju një precedentë i keq që qytetarët me iu bë barrë buxhetit të shtetit më vonë se sipas këtyre vlerësimeve po duket se është i tilë. Ne jemi për me i mbështetë qytetarët me çdo formë, unë nuk e tregova çka kom mundësi më me bë edhe kemi mundësi me bë çka është ligjore më shumë administrative pajtohem që kanë drejtë me i pasë ankesat e veta edhe nuk po e mbështesë kërkend që ju ka dhënë mjaftueshëm duke mos i përfshi se këtu po flitet vetëm për shtëpitë qysh janë vlerësu dhe nuk po flitet për pjesët përcjellëse, ato troje e ato se vetëm shtëpitë nuk janë bë. Megjithatë, jam i gatshëm qysh tash me bashkëpunu me këdo nuk kemi nevojë me pasë bashkëpunim mes dy personave, të krijojmë Komisionin që ti ndihmojmë këtij procesi. Unë kam me qenë deri aty ku kemi mundësi deri ku nuk shkelet ligji që kryhen procedurat dhe tutje janë Gjykatat që merren me këtë çështje. Ne nuk po ju thojmë qytetarëve mos shkoni në Gjykatë, iu ka bë e padrejtë sepse konsiderojmë që ju kanë shkelë të drejtat, pjesët e tjera çka thuhet kush çka ka keqpërdorë shumë minimale u mundova me i bë vetëm mos me i kontribu këtij debati. Jemi pro që qytetarët ti mbështesim deri kur ata të fitojnë të drejtën e vetë.

**Kryesuesja** - Ju kisha lutë mos me bo fushatë sepse kanë ardhë banorë të cilët janë në mes të rrugës dhe nuk dinë nga të ia mbajnë sepse sikur të kishin mundësi nuk ishin ardhë fare me na dëgju këtu çfarë po debatojmë edhe kuvendi është i të gjithëve nuk është vetëm i një zotri Samiu, apo i Mirenës, por këtu jemi të gjithë. Ne jemi mbledhë sot këtu dhe secili ka pasë ndonjë obligim, ndoshta sot por jemi mbledhë për nder të qytetarëve tonë për me iu ndihmu sado pak, atëherë e pashë që Kryetari propozoi një Komision të formohet, le të formohet një Komision që merret me detajet.

**Labinot Mirena**- Unë kisha tënë me e bë Komisionin pa Lëvizjen V ë etëvendosje se me e bë me ata vetëm sherrin ua shohim.

**Kryesuesja** - Atëherë shkojmë me formimin e një Komisioni 3 nga kuvendi, leekzekutivi edhe 1 përfaqësuesi i fshatrave, dhe z.Gashi propozoi Labinot Mirenën ( mbase është i asaj ane dhe dinë se qysh ka shku rrjedha më herët), Lëvizja VV propozoi z.Sami Ahmetin Po ashtu, u propozua që në këtë Komision të jetë edhe inicuesi i kësaj mbledhjeje nga radhët e AAK-së z.Xhelal Krasniqi,



nga Ekzekutivi u propozua nga Kryetari z.Berat Mehmeti si përfaqësues u propozua z.Afrim Mexhani pastaj u propozua z.Jeton Mjekiqi në vend të Labinot Mirenës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për morën Vendim për formimin e Komisionit me këta anëtarë:

1. Jeton Mjekiqi
2. Sami Ahmeti
3. Xhelal Krasniqi
4. Berat Mehmeti ( Ekzekutivi)
5. Afrim Mexhani ( përfaqësues i fshatit)

Ky Komision do të mirret me të gjitha procedurat në lidhje me zhvlerësimin e vlerësimit të fshatit Sibovc konkretisht lagjet Mexhuani dhe Kongjeli.

Ky komision e ka për obligim me raportu në Kuvend për çdo procedurë që ata fillojnë.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:06'**

**Procesmbajtësja**

  
Suzana Hashani

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

  
Vlora Mjekiqi Kabashi

